



СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

BE QENDRA E KUVENDIT

BE LAJME

janar 2016
BEQ 18/2016



PRIORITETE TË KRYESIMIT TË HOLANDËS ME KËSHILLIN E BASHKIMIT EVROPIAN



Holanda nga 1 janar 2016, e morri kryesimin me Këshillin e BE-së nga Luksemburgu. Kryesimi i Holandës do të jetë mandati i parë i treshit të ri kryesues, në të cilin hyjnë edhe Sllovakia dhe Malta. Më 30 qershor kryesimin do ta marrë Sllovakia dhe Malta. Këto tre shtete do të bashkëpunojnë deri në qershor 2017, me qëllim të realizimit të programit të vet 18 mujor, i cili mes tjerash nënkupton edhe hapjen e vendeve të reja të punës, rritje dhe konkurrencë, vendosje të unionit energjetik dhe politikës klimatike të orientuar drejt të ardhmes, forcimin e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.

Kombinimi efikas i masave evropiane dhe nacionale do të jetë baza kryesore për gjendjen e zgjidhjeve. Principi udhëheqës i Holandës është Unioni, i cili do të fokusohet në punët esenciale, në zhvillimin dhe vendet e punës përmes rinovimit dhe Unionit që është e lidhur me shoqërinë civile.

Kryesimi i Holandës do të fokusohet në sferat prioritare vijuese:

1. *Qasja gjithëpërfshirëse për migrim dhe siguri ndërkombëtare;*
2. *Evropa si novatore dhe krijuese e vendeve të punës;*
3. *Politikë energjetike progresive dhe politikë klimatike.*

Qasja gjithëpërfshirëse në migrimin dhe sigurinë ndërkombëtare

Kriza me migrimin zbuloi mangësi të ndryshme në sferat evropiane të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë të cilat kërkojnë aksion. Prioritet aktual është kontrolli efikas i kufijve të jashtëm të Evropës, përmirësimi i pranimit të refugjatëve në Evropë dhe në rajon, si dhe ndarja e barrës në mënyrë të drejtë. Gjithashtu, nevojitet bashkëpunim më i madh rajonal me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë të cilat drejtpërdrejt ballafaqohen me këtë sfidë. Është veçanërisht e rëndësishme të vendoset lidhje e fuqishme ndërmjet politikës së brendshme dhe të jashtme, me qëllim të përdorimit efikas dhe të integruar të spektrit të gjerë të instrumenteve të BE-së, si dhe përpjekjeve diplomatike aktive nga ana e përfaqësuesit të lartë të BE-së dhe vendeve anëtare. Me politikë të përbashkët dhe të jashtme të sigurisë së BE-së, mund të merret qëndrim aktiv dhe i bashkuar në lidhje me botën rreth saj dhe të gjendet përgjigje përkatëse të sfidave të jashtme dhe të brendshme gjithnjë më të ndërlikuara me të cilat ballafaqohet. Sulmet në Paris e theksuan nevojën për masa efikase për luftë kundër terrorizmit, si dhe realizimin e plotë të marrëveshjes për këmbim të të dhënave dhe bashkëpunim ndërmjet shërbimeve për siguri.

Holanda ka vendosur për përpunim të shpejtë të projektit për realizim të pakos për migrimin, të prezantuar nga Komisioni Evropian, me pasqyrë strategjike të politikës së jashtme dhe të sigurisë së BE-së.

Evropa si novatore dhe krijuese e vendeve të punës

Nën presion të krizës migruese, BE-ja e humbi nga shikimi rolin e saj si novatore dhe krijuese e vendeve të punës në Evropë, edhe krahas faktit se ai ka perspektivë të mirë për krijimin e rritjes stabile dhe novatore të vendeve të punës. Në kuadër të kryesimit të Holandës ky do të jetë prioritet i dytë në Unionin. Kjo do të thotë, realizim të marrëveshjes ekzistuese në të gjitha vendet anëtare, stimulim të sipërmarrësisë novatore, përforsim të shërbimeve të reja dhe sektorëve me potencial të lartë, investim i përbashkët në hulumtim, si dhe marrëveshje të balancuar tregtare me vendet e treta. Bizneseve doemos duhet t'u jepet hapësirë që të përtërihen dhe të hapen vende të reja pune. BE-ja doemos duhet të vazhdojë me modernizimin dhe thjeshtimin e legjislacionit, kështu që ligjet e BE-së me të vërtetë të jenë në funksion të qytetarëve, bizneseve dhe autoriteteve lokale.

Financa të shëndosha dhe eurozonë e fuqishme

Reformat strukturore dhe politika e shëndoshë fiskale, janë të frytshme dhe shumë vende anëtare gradualisht e gjejnë rrugën e tyre drejt rimëkëmbjes ekonomike dhe rritjes së punësisë. Vendet anëtare të BE-së doemos të vazhdojnë me reformat strukturore dhe politikën e koordinuar ekonomike. Në këtë mënyrë mund të ketë garanci për financat e shëndosha publike në ekonomitë moderne. Rëndësia e financave të shëndosha dhe eurozona e fuqishme, gjithashtu, shtrihen edhe në buxhetin shumëvjeçar evropian. Holanda do të fillojë iniciativë, që të fillojë debati për Buxhetin e ri dhe të reformuar shumëvjeçar.

Politike energjetike progresive dhe politika klimatike

Si prioritet i karterë, Holanda do ta potencojë kohezionin ndërmjet çështjeve të ndryshimeve klimatike, energjisë, mjedisit jetësor dhe qëndrueshmërisë. Holanda do të ushtrojë presion për zhvillimin e mëtutjeshëm të Komunitetit energjetik evropian, përmes përforsimit të furnizimit me energji, krijimit të tregut të brendshëm të energjisë, me çka BE-ja do të jetë më pak e varur në aspektin energjetik, si dhe zmadhimit të hulumtimeve dhe novacioneve në sferën e burimeve të rigjenerueshme të energjisë, për përcaktimin e ardhmërisë së politikës klimatike. Marrëveshja e Parisit, e cila u arrit në Konferencën e 21-të të Palëve të Konventës kornizë për

Përmbajtja e lajmeve:

Prioritetet e Holandës	1
Aktivitetet e Kuvendit	2
Në fokusin e parlamentit evropian	2
KOMISIONI EVROPIAN E PREZANTOI VLERËSIMIN E VET PËR PROGRAMIN E SHTATË KORNIZË PËR HULUMTIM	3
QENDRA E RE EVROPIANE PËR LUFTË KUNDËR TERRORIZMIT	3
VIDEO KONFERENCA E TREMBËDHJETË E LIDERËVE NGA RUTA E BALLKANIT PERËNDIMOR	4
KOMISIONI SOCIAL DHE EKONOMIK EVROPIAN KËRKOI QË KONSUMATORËT TË JENË	5
BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE ME MBËSHTETJE TË SHTËPISË SOFTUERIKE NOVATORE HOLLANDEZE	6
PËR 2,4% RROGA MË TË LARTA TË NËPUNËSVE	6
BASHKIMI EVROPIAN ME PRESION MBI GREQINË PËR PËRJASHTIM NGA	7
AMVISËRITË BRITANIKE ME VITE KANË PAGUAR FATURA MË TË LARTA PËR UJË	8
RËNIE TË ULËT TË EURO BANKËNOTAVE TË FALSIFIKUARA NË GJYSMËN E DYTË TË VITIT TË KALUAR	9
UDHËTIM RRETH BOTËS PA EMISIONE TË CO2	10
BE KALENDAR/ janar 2016	10

AKVITETET E KUVENDIT



Mbledhja e përbashkët e Komisionit për Çështje Evropiane dhe Këshillit Nacional për Eurointegrim

Më 20 janar 2016 Komisioni për Çështje Evropiane dhe Këshilli Nacional për Eurointegrim mbajtën mbledhje të përbashkët. Në mbledhje u prezantua Programi dhe prioritetet për punë e Kryesimit të Holandës me Këshillin e Bashkimit Evropian për periudhën janar-qershor, nga ana e ambasadorit të Republikës së Holandës në Republikën e Maqedonisë, SH.T. Vilem Vauter Pllomp.

Në mbledhje u ftuan të marrin pjesë edhe kryetaret, anëtarët dhe përfaqësuesit e Komisionit për Politike të Jashtme, Komisioni për Sistem Politik dhe Marrëdhënie ndërmjet Bashkesive, Komiteti i Perzier Parlamentar RM-BE dhe Këshilli Nacional për Eurointegrim.

Fjalime hyrëse në mbledhjen kishin ambasadori i Mbretërisë së Holandës në Republikën e Maqedonisë, z. Vilem Vauter Pllomp, zëvendëskryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i ngarkuar për

çështje evropiane, z. Fatmir Besimi dhe Shefi i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë, ambasadori Aivo Orav.

Me mbledhjen kryesoi kryetarja e Komisionit për Çështje Evropiane, znj. Ermira Mehmeti. Në debatin me mendime, propozime dhe komente morën pjesë deputetët: znj. Ermira Mehmeti, znj. Liljana Popovska, z. Orhan Ibrahim, znj. Nolla Ismajloska, z. Pavle Trajanov dhe z. Kenan Hasipi dhe prof. dr. Dimitar Mirçev anëtar i Këshillit Nacional për Eurointegrim, përfaqësues nga kabineti i Kryetarit të Republikës së Maqedonisë. Me mbledhjen u këmbyen mendime dhe qëndrime për gjendjet aktuale në Republikën e Maqedonisë, në aspekt të shkallës së realizimit të Marrëveshjes së Përzahinos, si kusht për zhblokimin e procesit eurointegruar të vendit dhe për marrjen e datës për fillim të negociatave për anëtarësim në BE.

www.sobranie.mk

NË FOKUSIN E PARLAMENTIT EVROPIAN

Seancë plenare 18-21 janar 2016, Strasburg.



Në seancën plenare të Parlamentit Evropian në Strasburg, eurodeputetët debatuan për sundimin e të drejtës dhe pavarësisë së mediave në Poloni. Kryeministri i Polonisë, znj. Beata Szydło i refuzoi kritikën e politikës së qeverisë së saj.

Gjatë debatit me kryetarin e Komisionit Evropian, Zhan Klod Junker dhe kryetari i Këshillit, Donald Tusk më shumë eurodeputetë theksuan vërejtje për liderët e BE-së për mospësuksin në ballafaqim me krizën e migruesve në Evropë. Deputetët, gjithashtu, biseduan për referendumin e ardhshëm për anëtarësim të Britanisë së Madhe në BE.

Në fjalimin e tij në seancën plenare të Parlamentit Evropian më 20 janar të këtij viti, Kryeministri i Holandës Mark Rute i theksoi prioritetet e Kryesimit të Holandës me Këshillin e BE-së. Ai u shoqërua nga ministri i Punëve të Jashtme Bert Koenders.

Eurodeputetët gjatë debatit theksuan se vendet-anëtare të BE-së duhet të bashkëpunojnë në ballafaqimin me kërcënimin terrorist që është në rritje. Gjithashtu, theksuan se vendimi i Francës për t'u thirrur në klauzolën e BE-së për mbrojtje reciproke duhet të shërbejë si nxitje për përforcimin e sigurisë

dhe mbrojtjes evropiane.

Bashkë me ministrin francez të punëve të jashtme Lloren Fabius, eurodeputetët biseduan për Marrëveshjen për ndryshimet klimatike në Paris. Theksuan se megjithëse ka rezultat pozitiv, ende shumë duhet të bëhet për ballafaqim me emisionet nga aviacioni dhe transporti.

Parlamenti miratoi rregulla të reja për siguri që të pengohet hyrja në BE e pajisjes mbrojtëse joadekuade dhe e rrezikshme për jetë, siç janë helmimet dhe veshjet mbrojtëse.

Me qëllim të rritjes së tregtisë elektronike, në rezolutën e miratuar eurodeputetët theksuan se duhet t'i vihet fund gjeoblokimit.

Propozim-rregullat e BE-së me të cilat mundësohet që ushqimi për fëmijë të përmbajë deri në tre herë më shumë sheqer sesa që rekomandohet nga Organizata shëndetësore botërore (OSHB) janë refuzuar nga eurodeputetët. Gjithashtu, ato kërkuan zvogëlim të limitit të përmbajtjes së sheqerit në BE që t'u përgjigjet rekomandimeve të OSHB-së për mbrojtje të fëmijëve të vegjël dhe foshnjave nga trashësia. Eurodeputetët me Elizabeta Bienkowska, komisarë përgjegjës për tregun e brendshëm debatuan nëse kufizimi për gazrat nxjerrëse të automobilave dizël për okside azoti (NOx), duhet të rritet edhe deri në 110%. Deputetët do të votojnë për propozimin gjatë mbledhjes së ardhshme.

KOMISIONI EVROPIAN E PREZANTOI VLERËSIMIN E VET PËR PROGRAMIN E SHTATË KORNIZË PËR HULUMTIM

Komisioni Evropian më 25 janar 2016 e shpalli evaluimin eks-post të Programit të 7-të kornizë (FP7) për financim të hulumtimeve në periudhën ndërmjet vitit 2007-2013.

Vlerësimi bazohet në raportin e grupit të pavarur të ekspertëve të nivelit të lartë, por edhe në përgjigjen e Komisionit të rekomandimeve të tyre të publikuara në dy dokumente juridike.

Konstatimet kryesore janë se FP7 është efikase në nxitjen e shkencës së shkëlqyeshme dhe forcimin e konkurrencës industriale në Evropë, duke kontribuar për rritje dhe vende pune në Evropë. Evaluimi, gjithashtu identifikon mënyra për përmirësimin e hulumtimit të fondeve dhe novacioneve të BE-së. Shumë çështje tashmë janë ndërmarrë nga ana e programit Horizont 2020 i cili është trashëgimtari i FP7.

Konkluzionet kryesore të Komisionit nga eks-post evaluimi i FP7 janë:

- FP7 është veçanërisht efektive në përfundimin e përsosjes shkencore. FP7 projektet deri më tani kanë gjeneruar 170.000 publikime me shkallë të qasjes së hapur prej 54% për të gjitha publikimet e recensuara shkencore të krijuara gjatë periudhës së FP7.
- FP7 kontribuoi për rritjen e konkurrencës industriale në Evropë. Gjatë FP7 u rrit pjesëmarrja e partnerëve privatë,
- FP7 ka ndikim pozitiv në rritjen dhe vendet e punës. Vlerësohet se FP7 do ta rrisë PBV-në

prej afro 20 miliardë eurosh në vit gjatë 25 viteve të ardhshme, ose gjithsej 500 miliardë euro përmes efekteve indirekte dhe të krijojë më shumë se 130 000 vendeve pune hulumtuese në vit (në periudhën prej 10 vitesh) dhe 160.000 vende të reja pune në vit (në periudhën prej 25 vitesh),

- FP7 i adreson sfidat shoqërore transnacionale,

- FP7 i përfshin dhe i trajnon talentet teknologjike dhe shkencore ndërkombëtare,

- FP7 është sistem i hapur i cili u mundëson më shumë se 21.000 organizatave të reja të marrin financa nga BE-ja.

Programi i shtatë kornizë i Komunitetit Evropian për hulumtim, zhvillim teknologjik dhe aktivitete demonstruese (FP7) zgjati nga viti 2007 deri në vitin 2013. Programi u strukturua në katër programe të veçanta për mbështetje të bashkëpunimit transnacional për hulumtim, zhvillim të karrierës së hulumtuesve individual, si dhe trajnim, mobilitet dhe përfundim të kapaciteteve hulumtuese në Evropë.

Programi horizont 2020 do të zgjasë nga viti 2014 deri në vitin 2020. Gjatë shtatë viteve përmes programit do të jenë të arritshëm 77 miliardë euro financim të hulumtimeve dhe novacioneve, pothuajse 40% shumë më e madhe sesa me programin FP7.



QENDRA E RE EVROPIANE PËR LUFTË KUNDËR TERRORIZMIT

Në mbledhjen joformale të ministrave të drejtësisë dhe punëve të brendshëm në Amsterdam, më 25 janar 2016 Evropoli e lëshoi në përdorim Qendrën evropiane për luftë kundër terrorizmit (ECTC). ECTC do të ballafaqohet me çështjet, siç janë luftëtarët e huaj dhe ndarjet e informatave në lidhje me financimin e terrorizmit, propaganda online dhe tregtia me armë.

Kërcënimet terroriste më serioze në 10 vitet e fundit

Evropa ballafaqohet me kërcënimin më serioz terrorist në 10 vitet e fundit. Në kombinim me numër gjithnjë më të madh të luftëtarëve të huaj, kjo është sfidë e re për vendet anëtare të BE-së. "Qendra do t'i përmirësojë koordinimet operative dhe këmbimin e informatave ndërmjet organeve për zbatim të ligjit", deklaroi ministri holandez i sigurisë dhe drejtësisë, Ard van der Steur, në fillim të takimit. Kjo është e nevojshme për luftë kundër krimin të organizuar, rrjeteve terroriste dhe luftëtarëve të huaj.

Si është organizuar qendra

Kjo është pjesë e organizatës së Evropolit, që do të udhëhiqet nga Spanjoli Manuel Navaret Paniagua. Momentalisht ka personal prej 39 personave, plus pesë ekspertë të risistemuar. Ato do të punojnë me qendra tjera operative në kuadër të Evropolit.

Hetimi i krimit financiar

Evropoli ka rol qendror në përgjigjen evropiane të kërcënimeve terroriste. Për shembull, pas sulmeve në Paris Evropoli sistemoi 60 oficerë për mbështetje të hetimeve franceze dhe belge në vëllazërinë Grupi punues special, që rezultoi me më shumë se 1600 role udhëheqëse të oficerëve në zbulimin e transaksioneve të dyshimta financiare. Hetimet financiare janë instrument efikas në luftën kundër krimin të organizuar dhe terrorizmit dhe një nga prioritetet e kryesimit të Holandës në BE.



VIDEO KONFERENCA E TREMBËDHJETË E LIDERËVE NGA RUTA E BALLKANIT PERËNDIMOR



Më 22 janar 2016 u mbajt video konferenca e 13-të ndërmjet personave kontaktues të emëruar në takimin e liderëve të Rutës së Ballkanit Perëndimor që u mbajt më 25 tetor vitin e kaluar.

Përfaqësues të lartë nga vendet dhe agjenci që ishin të pranishëm në mbledhje kishin diskutim të detajuar për trendët e fundit në lidhje me kufijtë e jashtëm dhe kapacitetin pranues.

Në deklaratën e liderëve për pikat 1 dhe 9 për këmbim të informatave dhe bashkëpunim efektiv, pjesëmarrësit i përsëritën angazhimet e tyre për këmbim të shpejtë dhe stabil të informatave ndërmjet personave për kontakt. Informatat duhet të shfrytëzohen si mekanizëm për paralajmërim të hershëm me çka sigurohet qasje kolektive tejkuftare dhe do të shmangen veprime të njëanshme të cilat mund të shkaktojnë seri reagimesh.

Në lidhje me pikën 13 e cila ka të bëjë me menaxhimin kufitar liderët diskutuan për menaxhim të ndryshëm me kalime kufitare dhe këmbim informatash ndërmjet të dyja vendeve. Kjo i përfshin pikat kryesore vijuese:

- Greqia dhe Republika e Maqedonisë informon për përmirësimin e këmbimit të informatave dhe koordinimit të aktiviteteve lidhur me menaxhimin kufitar, si dhe për përforcimin e mbështetjes së Fronteksit të kufijve ndërmjet Greqisë dhe Republikës së Maqedonisë.

- Komisioni informoi për rezultatin e video-konferencës të mbajtur ndërmjet organeve policore nacionale nga të gjitha vendet pjesëmarrëse.

- Austria, Kroacia, Gjermania, Greqia, Serbia, Sllovenia dhe Republika e Maqedonisë informuan që praktikisht për momentin bëhet kufijtë e tyre të brendshme.

- Kryesimi i Holandës paralajmëroi takim të nivelit politik i cili është paraparë të mbahet në margjinat e mbledhjes joformale të Këshillit për drejtësi dhe punë të brendshëm më 25 shkurt ndërmjet Austrisë, Kroacisë, Gjermanisë, Greqisë, Serbisë, Sllovenisë dhe Republikës së Maqedonisë. Në mbledhjen do të bisedohet për masat e fundit të ndërmarrë të Rutës së Ballkanit Perëndimor.

Në deklaratën për pikat 5 dhe 6 të cilat kanë

të bëjnë me mbështetjen dhe strehimin e refugjatëve, liderët theksuan se UNHCR-ja parasheh sigurim të 20 mijë vendeve për pranim në vendosjen private përmes sistemit të vauçerit me partnerë nga Greqia.

Grupi do të vazhdojë me kontakte bilaterale në ndërkohë të sigurojë komunikim plotësues, koordinim dhe bashkëpunim për zgjidhjen e rrjedhave të migrimit dhe të sigurohet trajtim human për personat që kërkojnë azil në Evropë.

Më 21 tetor 2015, kryetari i Komisionit Evropian z. Junker mbajti takim liderësh për valën e refugjatëve përgjatë rutës së Ballkanit Perëndimor dhe e theksoi situatën e jashtëzakonshme e cila zhvillohet në atë rrugë.

Të pranishëm në takimin e liderëve ishin shefat e shteteve ose qeverive të Shqipërisë, Austrisë, Bullgarisë, Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Gjermanisë, Greqisë, Hungarisë, Rumanisë, Serbisë dhe Sllovenisë. Zyra evropiane për mbështetje të azilit (ZEMA) dhe Agjencia evropiane për menaxhim me bashkëpunim operativ të kufijve të jashtëm të vendeve anëtare të BE-së (Fronteks), gjithashtu ka përfaqësues të tyre.

Më dhjetor 2015, Komisioni Evropian e publikoi raportin për progresin në masat e ndërmarrë për ballafaqim me refugjatët dhe krizën me migruesit përgjatë rutës së Ballkanit Perëndimor.

KOMISIONI SOCIAL DHE EKONOMIK EVROPIAN KËRKOI QË KONSUMATORËT TË JENË PJESËMARRËS AKTIVË NË TREGUN ENERGJETIK

Dizajni i ri i tregut energjetik, marrëveshje e re për konsumatorët e energjisë elektrike dhe etiketat për efikasitetin energjetik janë pjesë e pakos energjetike prej tre mendimesh të votuara në mbledhjen e Komisionit social dhe ekonomik evropian (EESC) më 20 janar 2016.

Duke ndjekur marrëveshjen e SOR21 të miratuar në fund të vitit 2015, fokusi kryesor në debatin energjetik është vënë në atë si pjesë e tranzicionit ndaj ekonomisë me nivel të lartë të karbonit mund të arrihet praktikisht në vende të ndryshme. Çështje kryesore është dizajni i tregjeve energjetike në lidhje me rregullat, infrastrukturën, si dhe pjesëmarrësit në treg. Me dizajnin e tregut të energjisë elektrike do të sigurohet se ndryshimi i burimeve të rigjenerueshme është e dobishme në mënyrë universale.

BE-ja do të duhet të ndërmarrë aksion më të madh që të sigurohet se çmimet e energjensëve do të jenë më transparente dhe do të paraqesin pasqyrë të gjenerimit aktual dhe shpenzimeve të jashtme; doemos duhet t'u mundësohet konsumatorëve të bëhen pjesëmarrës aktivë në tregun përmes sigurimit të tyre me informata dhe resurse përkatëse; dhe doemos duhet të mënjanohe pengesat për qasje në tregun e numrit të zmadhuar të iniciativave lokale për vetë-prodhimin dhe vetë-furnizimin.

EESC pajtohet me Komisionin Evropian për nevojën për ta lënë "konsumatorin në zemrën e BE-së". Me qëllim që konsumatorët të marrin pjesë në tregun e energjisë, ato duhet të kenë qasje në teknologjitë inteligjente, informatat, trajnimin dhe financat. Konsumatorët duhet të kenë liri për të luajtur rol aktiv në sistemin energjetik të kenë të drejtë të zgjedhjes dhe lehtë të kalojnë ndërmjet prodhuesve dhe distributorëve të energjisë elektrike. Sipas mendimit EESC theksoi se konsumatorëve u jepen më shumë të drejta dhe mundësi, por rritet edhe përgjegjësia për to. Mendimi tregon se problemi social në rritje e varfërisë energjetike duhet të zgjidhet me ndihmën e masave përkatëse të politikës sociale.

Komisioni social ekonomik evropian nxori seri rekomandimesh me të cilat sigurohet efikasiteti efektiv dhe i uniformuar energjetik në Evropë në mendimin e tij për Kornizën e shënimit të efikasitetit energjetik, si përgjigje

e propozimit të Komisionit Evropian. Karakteristikat e prodhimit, faktikisht duhet t'i përgjigjen etiketës, duhet të ketë kontrolle më të rrepta të prodhimeve për shitje dhe duhet të futet Sistemi i përbashkët i gjerë evropian i dënimeve.

Etiketat, gjithashtu duhet të përmbajnë edhe informata tjera për konsumatorët, siç janë konsumimi i energjisë së prodhimit dhe afati i tij minimal - kjo do ta bëjë prodhimin energjetik me të vërtetë të krahasueshëm në lidhje me shpenzimet dhe do ta dekurajojë vjetërsimin e planifikuar. Vëmendje të veçantë duhet t'u kushtohet prodhimeve të importuara nga vendet e treta, që të mbrohen nga konkurrenca jolohale dhe mashtrimi.

Sfera tjetër e cila doemos duhet të ndiqet është tregtia online - kjo është një sferë e cila është anashkaluar dhe ku etiketat energjetike nuk janë gjithmonë të spikatura dhe të dukshme. Unioni do të duhet të bëjë çmos që prodhimet me efikasitet të lartë t'i bëjë të disponueshme për grupet më të varfra sociale - kjo do të jetë një prej mënyrave për ballafaqim me problemet e varfërisë energjetike që do të ndikojë në më shumë se 50 milionë banorë në tërë territorin e BE-së.

<http://www.eesc.europa.eu/?i=portal.en.the-committee>



«Unioni do të duhet të bëjë çmos që prodhimet me efikasitet të lartë t'i bëjë të disponueshme për grupet më të varfra sociale »

BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE ME MBËSHTETJE TË SHITËPISË SOFTUERIKE NOVATORE HOLANDEZE eVISION



Industria softuerike emision dhe Banka evropiane e investimeve (BEI) 25 janar 2016 nënshkruan marrëveshje për hua prej 13.5 milionë euro. Ky investim do të mundësojë që emision ta përforcojë pozitën globale si furnizues udhëheqës të kontrollit digjital të zgjidhjeve të punës. Kompania do të jetë IKT biznesi i dytë holandez që do të shfrytëzojë mjete të programit "InnovFin - BE financa për novatorë".

milion euro grant nga programi Horizonti 2020.

InnovFin financim të rritjes ofron hua të subordinuar të lartë në afat të gjatë me qëllim përmirësimin e qasjes në financa për ndërmarrje novatore kryesisht më të mëdha (deri në 3000 të punësuar), gjithashtu për ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

eVision do të vazhdojë të investojë në platformën e saj udhëheqëse softuerike që do t'u ndihmojë kompanive për kontroll të operacioneve të tyre. Novacionet në kontrollin digjital të punës do të ndihmojë në kompanitë të përgjigjen në nevojën e rritur për efikasitet operativ dhe kontroll të sigurisë.

eVision industria softuerike është lider global në softuer për kontroll të punës. Kompanitë nga sfera e naftës dhe gazit, industritë kimikale dhe industritë tjera me rizik të lartë janë drejtuar kah ju për përmirësimin e kontrollit mbi proceset e veta operative, që rezulton në menaxhim plotësisht të mirë personal në kohë reale me rrezik korporativ, si dhe rritje të efikasitetit operativ.

Portofolioja e integruar plotësisht e prodhimeve të eVision përfshin softuer për proceset afariste siç janë leja për punë, vlerësimi i rrezikut, menaxhimi i ndryshimeve.

Kompania është me seli në Hagë, Holandë me zyra rajonale në Britaninë e Madhe, në Lindjen e Afërt dhe në SHBA, eVision ka rrjet global të partnerëve dhe klientëve prej më shumë se 35% në vitin 2015, ndërsa më shumë se dyfish është rritur numri i marrëveshjeve.

«Novacionet në kontrollin digjital të punës do të ndihmojë në kompanitë të përgjigjen në nevojën e rritur për efikasitet operativ dhe kontroll të sigurisë»

"Partneriteti me BEI na jep fleksibilitet dhe liri të vazhdojmë me investimet tona në hulumtim dhe zhvillim që është gur themel i suksesit tonë" theksoi Pitel Kortenhorst, drejtor ekzekutiv i eVision.

Banka evropiane e investimeve në bashkëpunim me Komisionin Evropian, siguron financa dhe ekspertizë për projekte të qëndrueshme investuese që kontribuojnë për avancimin e qëllimeve të politikës së BE-së. Në gusht 2015 eVision ishte kompania e parë holandeze të cilës duhet t'i ndahen 2,3

PËR 2.4% RROGA MË TË LARTA TË NËPUNËSVE NË BRUKSEL

Rrogat e afro 55.000 nëpunësve të BE-së këtë vit do të jenë më të lartë për 2,4%, që do të thotë se do të përfshijnë më shumë se 100 milionë euro nga buxheti i bllokut. Pas dy vitesh pakënaqësi nga ana e nëpunësve shpuri në marrëveshje me BE-në dhe formulë të re për përlogaritje të rrogave. Rrogat e nëpunësve të BE-së në pesë vitet e fundit u rritën mesatarisht për gjysmë përqindje në vit ose shumë më e vogël se rroga e nëpunësve shtetëror nacional.

të aplikohet në mënyrë automatike. Kjo formulë i përfshinë shpenzimet për jetesë në Belgjikë dhe Luksemburg, ku do të qëndrojnë shumica e të punësuarve të BE-së dhe shporta e rrogave të nëpunësve shtetërore në 11 vende anëtare.

Rritja e rrogave për 2,4% do të aplikohet në mënyrë retroaktive nga korriku i vitit 2015 dhe do të vlejë për gjithë vitin 2016.

Siç transmeton agjencia informatike shtetërore bullgare BTA, rritja vjen pas dy vitesh nga ngrirja e rrogave të nëpunësve të BE-së me kërkesë të qeverive nacionale. Kjo rezultoi me greva të të punësuarve në disa institucione në BE në vitin 2020 dhe 2013.

Kryetari i Komisionit Evropian, Zhan-Kllod Junker dhe kryetari i Këshillit, Donalld Tusk, do të marrin pothuajse 700 euro rroga më të larta ose 31.272 në muaj, publikoi agjencia gjermane gazetareske DPA, duke u thirrur në shkrimet e Bildl.

Me marrëveshjen e arritur në vitin 2014 ndërmjet BE-së dhe të punësuarve të saj, është paraparë futja e një sistemi të ri për rroga. Qëllimi i marrëveshjes është futja e formulës që do

Gazeta e njëjtë gjermane, publikoi se pas rritjes së rrogës mujore për shtatë zëvendëskryetarë të Komisionit do të rritet për 633 euro dhe do të arrijë 27,953 euro.

BASHKIMI EVROPIAN ME PRESION MBI GREQINË PËR PËRJASHTIM NGA SHENGEN

BE ushtron presion mbi qeverinë greke në lidhje me valën e refugjatëve dhe migruesve. Disa vende anëtare tashmë vendosën kontrolle të jashtëzakonshme në kufijtë e tyre dhe nëse nuk futet kontroll më i rreptë, paralajmëruan se do të mund ta përjashtojnë Greqinë nga Shengen zona.

BE-ja e paralajmëroi Greqinë se mund që në maj të ballafaqohet me kontrolle plotësuese kufitare nga shtete tjera në zonën e Shengenit nëse nuk i përmirëson, siç ceket, "lëshime serioze" në kufijtë e jashtme të Shengenit.

Anëtarët e BE-së filluan gjithnjë më rreptësisht ta kritikojnë Athinën për atë se si ballafaqohet me krizën e refugjatëve dhe të migruesve. Përfaqësues të lartë konsiderojnë se kjo është mënyra e vetme për ta bindur Athinën për të kërkuar ndihmë nga Fronteks për mbrojtje të kufijve të tyre.

Ministritë e punëve të jashtme të BE-së, më 25 janar u takuan në Amsterdam në mbledhje joformale, ku u shqyrtua opsioni për vazhdimin e kontrolleve kufitare kohore në zonën e Shengenit, me qëllim të kontrollimit të valës së refugjatëve. Ministrat e disa shteteve evropiane tashmë thirrën që Greqia të përjashtohet nga Zona e Shengenit bile edhe nga BE-ja, nëse vazhdon t'i lëshojë migruesit që vijnë drejt Evropës.

Sipas nenit 26 të Marrëveshjes së Shengenit, i cili asnjëherë deri më tani nuk u zbatua, lejohet që njëra ose më shumë anëtare të fusin kontroll nëntëvjeçare në kufijtë e tyre. Këto masa janë pjesë e planit të madh të BE-së që të pengohen mijëra migrues që hyjnë në zonën e saj.

Ministria e Punëve të Brendshme të Austrisë Johan Mikl-Llatner paralajmëroi se kufiri i jashtëm i BE-së do të zhvendoset drejt Evropës Qendrore, nëse Greqia nuk e përmirëson kontrollin e kufirit me Turqinë, dhe se duhet të përjashtohet nga zona e Shengenit nëse nuk i përmbush detyrimet për sigurimin e kufijve të jashtëm të BE-së nga vala e migruesve, Greqia duhet t'i përforcojë resurset e veta dhe të pranojë ndihmë deklaroi ministrja e punëve të jashtme.

KE konsideron se duhet urgjentisht të ndërmerren aktivitete që të pengohet

vazhdimi i kontrolleve kufitare në zonën e Shengenit. Komisioni do të rekomandojë masa kolektive dhe deri në muajin maj do të bëjë vlerësim nëse Athina i ka zbatuar. Kjo ishte edhe paralajmërim i Donalld Tusk, kryetar i Këshillit të BE-së, kur ai deklaroi BE-së i mbeten edhe dy muaj për të gjetur dalje nga kriza e refugjatëve, e nëse nuk ndodh kjo, kjo do të thotë fund i Shengenit.

Merkel deklaroi se duhen më shumë sugjerime për ballafaqim me krizën e refugjatëve gjatë samitit të ardhshëm të BE-së, që do të mbahet në Çeki më 15 shkurt, ku do të shqyrtohen zgjidhje për krizën me refugjatët, për mbrojtje më të mirë të shenjën zonës dhe krijim eventual të linjës kufitare rezerve në Maqedoni dhe Bulgari. линија во Македонија и Бугарија.

<https://euobserver.com/justice/131975>



«Anëtarët e BE-së filluan gjithnjë më rreptësisht ta kritikojnë Athinën për atë se si ballafaqohet me krizën e refugjatëve dhe të migruesve. »

AMVISËRITË BRITANIKE ME VITE KANË PAGUAR FATURA MË TË LARTA PËR UJË



Amvisëritë në Britaninë e Madhe kanë paguar për ujë më shumë sesa që është nevojitur, sepse trupi rregullator i formuar për mbrojtje të konsumatorëve pas privatizimit para një çerek shekulli, me vite i ka përlogaritur gabimisht limitet e çmimeve, tregoi raporti i komitetit parlamentar kompetent. Kompanitë për furnizim të ujit për shkak të përlogaritjeve të këqija të rregullatorit dhe si rezultat i llogarive të larta për qytetarët kanë realizuar fitim më shumë se një miliardë funta për pesë vite. Faturat e amvisërive për ujë janë rritur në pothuajse 400 funta në vit.

Trupi rregullator për sektorin e furnizimit me ujë Ofuat (Ofwat) i ka vlerësuar shpenzimet e kompanive për furnizim me ujë, vlerësoi Komiteti për ndjekjen e faturave publike në Parlamentin Britanik.

Kryetarja e Komisionit për Financa Publike Meg Hiler thotë se atë që e ka bërë trupi kompetent për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve ka bërë gabime të tilla serioze do të pritet me ashpërsi nga opinioni.

"Ofuat u formua me qëllim të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, nga të cilat shumica nuk mund të zgjedhin furnizues të ujit dhe doemos duhet të paguajnë fatura prej disa qindra funta. Ky është shkak për amvisëritë do të tronditen kur do të shohin se faturat mund të jenë më të ulëta nëse Ofuat ka pasur qasje më ndryshe në përcaktimin e çmimit të kompanive për furnizim me ujë", theksoi Hiler.

"Kërkojmë transparencë më të madhe të" profitit të papritur për furnizuesit me ujë dhe aksion efikas profiti të bartet te konsumatorët", theksoi Hiler dhe shtoi se para Ofuat qëndrojnë sfida të mëdha. Ajo theksoi se Ofuat doemos duhet të krijojë dhe prezantojë shpejt plane të qarta që të arrihet aranzhman më i mirë për konsumatorët edhe për tani edhe për të ardhmen.

Bordi për financa publike i parlamentit britanik vërtetoi se Ofuat i formuar për realizimin e të drejtave të konsumatorëve, për përcaktimin e çmimit të ujit i ka vlerësuar shpenzimet e kompanive përfshirë edhe tatimet.

Shërbimi nacional për supervision e ka rishqyrtuar profitin e kompanive për furnizim me ujë në vitin 2015 dhe ka konstatuar se kanë pasur dobi nga tatimet më të ulëta se çmimet e pritura dhe të ulëta për ngarkim duke pasur parasysh atë që Ofuat e ka përcaktuar çmimin më të lartë të ujit.

Rezultati tregon se profiti i kompanive për furnizim me ujë për faturat janë gjithnjë më të mëdha se ajo që nevojitet në periudhën 2010-2015 dhe janë më të lartë për së paku 1,2 miliardë funta.

Gjithashtu është konstatuar se Ofuati ka

tentuar të sigurohet se këtë fitim do ta ndajë me konsumatorët "gjë që ka dhënë vetëm rezultate të kufizuara të cilat janë shumë të ndryshme" nga kompania deri në kompani.

Në raportin paralajmërohet mundësia se konsumatorët në zonën me furnizim të kufizuar me ujë paguajnë kapacitete të reja të shtrenjta megjithëse do të ishte më lirë që furnizuesi i tyre në tregti me kompanitë tjerë të sigurojë livrim adekuat.

Nga Ofuat kërkohet të analizohet se si kompania ka përlogaritur shpenzime në bazë të ngarkimeve me borxh dhe tatimeve dhe ta njoftojë opinionin cili është qëllimi për përmirësimin e punës së vet.

Industria për furnizim në Angli dhe Uells u privatizua në vitin 1989 dhe tani përbëhet prej 18 kompani të pavarura private të cilat janë monopol furnizues për 22 milionë amvisëri.

Nga viti 2014-2015 fatur mesatare të amvisërisë për ujë dhe kanalizim ishte 396 funta, e cila është reale për 40% më shumë se çmimi para privatizimit. Sipas konstatimeve, pjesa më e madhe e kësaj rritjeje të çmimeve është realizuar në pesë vitet e para, në periudhën 1990-1995.

Drejtori i Ofuat, znj. Ketrin Ros theksoi se rregullatori do t'i shqyrtojë konstatimet në raport. Ajo thotë se konstatimet në raportin për profitin e kompanive për furnizim me ujë janë në lidhje me vendimet e Ofuat prej para gjashtë vitesh dhe shtoi se ato janë të vetëdijshme për situatën e shkaktuar për konsumatorët nga viti 2012 dhe se kanë ndërmarrë masa që kompania të kthejë 435 milionë funta.

Ajo theksoi se Ofuat kanë futur ndryshme për kompaninë që të jetë më transparente dhe më e qëndrueshme dhe planifikojnë që me ndryshimet e reja ta kthejnë mirëbesimin te konsumatorët. зголемување на цените е остварен во првите пет години, во периодот 1990-1995.

Директорот на Офват, г-ѓа Кетрин Рос рече дека регулаторот ќе ги разгледа наводите во извештајот. Таа вели дека наводите во извештајот за профит на компаниите за водоснабдување се во врска со одлуките на Офват од пред шест години и додаде дека тие биле свесни за предизвиканата ситуација за потрошувачите од 2012 година и дека преземале мерки компанијата да врати 435 милиони фунти.

Таа посочи дека во Офват вовеле промени за компанијата да биде потранспарентна и одржлива, и планираат со новите измени да ја стекнат довербата на потрошувачите.

«тë dhënat tregojnë se faturat për ujë për borxhet e amvisërive britanike tejkalojnë dy miliardë funta»

RËNIE TË ULËT TË EURO BANKËNOTAVE TË FALSIFIKUARA NË GJYSMËN E DYTË TË VITIT TË KALUAR

Gjithsej 445 mijë euro bankënota të falsifikuara janë tërhequr nga qarkullimi në gjysmën e dytë të vitit 2015. Mashtruesit shpesh falsifikojnë bankënota prej 50 euro, 83% nga të gjithë bankënotave prej 20 deri në 50 euro.

Të gjithë euro bankënotat mund të kontrollohen duke shfrytëzuar metodën "prekje, pamje dhe pjerrësi". Euro bankënotat vazhdojnë të jenë mënyrë e besueshme dhe e sigurt dhe mundësi për pagesë. Numri i eurobankënotave të falsifikuara të cilat janë tërhequr nga përdorimi në gjysmën e dytë të vitit 2015 është zvogëluar vetëm për 2% më pak se gjysma e parë e vitit, kumtoi Banka evropiane qendrore (BEQ), duke paralajmëruar opinionin t'u kushtojë vëmendje bankënotave që i shfrytëzon.

Megjithatë nga BEQ-ja theksojnë se numri i bankënotave të falsifikuara mbetet shumë i ulët në krahasim me rritjen e numrit të bankënotave të vërtetë në qarkullim, të cilat janë mbi 18 miliardë në gjysmën e dytë të vitit 2015.

Eurosistemi u ndihmon personave që të bëjnë dallime ndërmjet bankënotave të vërteta dhe të falsifikuara, dhe t'u ndihmojë profesionalisht me teknologji që është mbështetur nga organe më të mëdha që lëshojnë bankënota në botë, që mundëson njohje të shpejtë të falsifikimit digjital. Këto aparate për antifalsifikim i pengojnë kompjuterët personalë dhe aparatet tjerë të incizojnë dhe riprodhojnë fotografi nga bankënotat e mbrojtura. Bankënotat e reja të serisë "Evropa" do të jenë më të sigurt, kjo do të ndihmojë në mirëmbajtjen e mirëbesimit në valutën si mjet për pagesë.

Ruajtja e integritetit të euros është detyrë e Eurosistemit i cili do të vazhdojë me përmirësimin e cilësisë dhe teknologjisë së bankënotave.

Jo interesante për falsifikatorët janë bankënotat prej 5 deri në 200 euro, tregojnë të dhënat e BEQ, një pjesë shumë e madhe e bankënotave të falsifikuara - 98% gjenden në vendet e eurozonës. Vetëm rreth 1,5% janë zbuluar në vendet anëtare të BE-së jashtë eurozonës, ndërsa më pak se 0,7% - në pjesë tjera të botës.

Bankënota e re prej 20 euro e cila u lëshua në qarkullim më 25 nëntor 2015, dizajni i ri përmban karakteristika novatore të sigurisë, me çka maksimalisht do të pengohet çfarëdo mundësi për falsifikim.



<https://www.ecb.europa.eu/press/pr/date/2016>

Periudha	2012/2	2013/1	2013/2	2014/1	2014/2	2015/1	2015/2
Nr. i bankënotave të falsifikuara	280,000	317,000	353,000	331,000	507,000	454,000	445,000

Të dhënat e raportit gjysmë vjetor të euro bankënotave të falsifikuara



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

BE QENDRA E KUVENDIT

Adresa: 11 Tetori nr. 10, Shkup, 1000

Telefon: +389 2 3 11 22 33 lokal 414 dhe 289

Phone: 555-555-5555

Fax: 555-555-5555

E-mail: someone@example.com

www.sobranie.mk

Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në periudhën janar 2011-qershor 2012 ishte zbatuar IPA Projekti për "Ndihmë teknike për Parlamentin", qëllimi i përgjithshëm i të cilës ishte përforsimi i kapacitetit institucional të Kuvendit dhe me atë përmirësim të transparencës dhe përgjegjësisë të saj para qytetarëve.

Në korniza të IPA projektit, ishte siguruar ndihmë financiare dhe profesionale për vendosje të BE qendrës në Kuvend.

Qëllimi i formimit të BE qendrës është deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe Shërbimit të Kuvendit t'u sigurohet qasje më e mirë në informata të lidhura me BE çështjet.